



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
**Komuna e Drenasit**  
Zyra e Kryetarit



01- Nr 030/01-32698 dt. 16.07.2021

Në vështrim të nenit 13, 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 14, pika 7 të Rregullores së Punës për Zbatimin e Auditimit dhe Planeve të Veprimit, procedurave standarde të operimit për trajtimin e të gjeturave dhe zbatimin e rekomandimeve të Auditimit të Jashtëm, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

### **V E N D I M**

Për Caktimin e Koordinatorit të Procesit

- I. Z. Enver Hoxha, caktohet zyrtar përgjegjës kontaktues për komunikim me Zyrën Kombëtare të Auditimit për vitin 2020, lidhur me komentimin e rekomandimeve me të draft raportit, hartimin e planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve, si dhe raportimin e shkallës së implementimit në kuvendin e komunës, deri me datën 30 shtator 2021, respektivisht datën 15 mars 2022.
- II. Detyrat e Koordinatorit të Procesit janë: 1. Përcakton Përgjegjësit për ofrimin e komenteve, 2. Tek USSP dorëzon listën e përgjegjësve për nxjerrjen e Vendimit, 3. Grumbullon komentet dhe evidencën e pranuar nga Kryesuesi i GP, 4. Organizon takime të përbashkëta me USSP dhe GP për komentet e grumbulluara, 5. Njofton kryesuesin dhe GP për afatin kohor për dorëzimin e Draft PV, 6. Përgatit planin kohor dhe ndërmerr aktivitetet për monitorimin sistematik të zbatimit të PV, 7. Në bashkëpunim me NJAB përgatite raport për USSP me rastin e rishikimit të zbatimit të PV.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdes: Kryetari i Komunës dhe Drejtoratet përkatëse.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryetarit i komunës.

  
**Kryetari i Komunës**  
  
**Ramiz Uldrovci**

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Z. Enver Hoxha;
- Të gjitha drejtorive;
- Njësisë së Auditimit të Brendshëm;
- Arkivit të komunës së Drenasit.